



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 738/1 prot.

Tiranë, më 09.07.2021

VENDIM

Nr.95, datë 09.07.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 210, DATË 28.12.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 210, datë 28.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 10551, datë 26.4.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.”*

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 884 prot., datë 16.11.2020, nëpunësi doganor ***** ka parashtruar pretendimin se transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin *“Doganier, Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ, Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit (Aposterior Operativ 5 ditor), Departamenti Operativ-Hetimor”* dhe vazhdimi i tij, janë bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që rregullojnë transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 210, datë 28.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 10551, datë*

*26.4.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.”*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.210, datë 28.12.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “*Doganier, Zyra e Kontrollit, Sektori i Kontrollit të Sigurisë*”, Dega Doganore Durrës, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar dhe mungon pëlqimi i nëpunësit për të vazhduar në atë pozicion pune.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 210, datë 28.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr.11827/1 prot., datë 02.07.2021, ka marrë masa për zbatimin e vendimit paralajmërues. Konkretisht, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr.11826 prot., datë 01.07.2021, për rikthimin e nëpunësit civil ***** në pozicionin e mëparshëm të punës bazuar në nenin 48, pika 4, e ligjit nr.152/2013, “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 210, datë 28.12.2020, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 10551, datë 26.4.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.”*

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.210, datë 28.12.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtorja e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha